



Komuna e Shtimes

Zyra e Prokurimit

Nr. 03 / 1 / 81

Datë 15 / 11 / 2018

KONTRATË PËR FURNIZIM

Komuna Shtime Rr. „Tahir Sinani „, tel. 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit në njëren anë:

dhe

“ Trendy Home “SH.P.K Prizeren , Lupishtë me pronar Mehdi Lumi tel . 044/232-927, ne anën tjetër, janë pajtuar për :

“Furnizim me inventarizim për aneksin e objektit të administratës “ (faza e dytë)

me numër Identifikues 617-2018-105-136

Neni 1

Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë

“Furnizim me inventarizim për aneksin e objektit të administratës” (faza e dytë)

1.2 Kontrata hynë në fuqi me 15.11.2018 dhe përfundon me 20.12.2018

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 12 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë : Kuvendi Komunal Shtime .

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Te gjitha pozicionet perfshijn furnizim dhe montim, materialet te jene te kualitetit te lartë dhe sipas standardeve. Kompania fituese pas nenshkrimit te kontrates duhe te sjell(ofroj) te menaxheri I kontrates disa modele(tipe) te materialeve per te gjitha pozicionet dhe te marr aprovimin nga menaxheri per llojin, ngjyren, formen etj

Neni 2

Ligji i aplikueshëm

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

Neni 3 Çmimi

**3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: 6640.00 €
(Gjashtëmije e gjashtëqinde e katerdhjete euro)**

Te gjitha pozicionet perfshijn furnizim dhe montim, materialet te jene te kualitetit te lartë dhe sipas standardeve. Kompania fituese pas nenshkrimit te kontrates duhe te sjell(ofroj) te menaxheri I kontrates disa modele(tipe) te materialeve per te gjitha pozicionet dhe te marr aprovimin nga menaxheri per llojin, ngjyren, formen etj

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimi të secilës dërgesë (Faturë) nga OE dhe raporti i Menaxherit të Kontratës të caktuar nga AK për furnizimin e kryer .

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *furnizimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *furnizimeve*

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [furnizimeve] [punëve] [shërbimeve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontraktojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit

Ekonomik shumë që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrihet të plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në gjykatën kompetente në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi


14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues


Emri:	Mehdi Lumi	Emri:	Havë QARRI
Pozita:	Pronar	Pozita:	u.d.Menaxher i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	15 11 2018	Data:	15 11 2018
Vula:		Vula:	



PARAMASA DHE PARALLOGARIA

"Inventarizimi i aneksit te objektit te administrates ne Shtime" (faza e dyte)


Nr.	PËRSHKRIMI I PUNËVE	Njësia	Sasia	Çmimi me TVSH	Shuma
	Vërejtje: Te gjitha pozicionet perfshijn furnizim dhe montim, materialet te jene te kualitetit te lartë dhe sipas standardeve. Kompania fituese pas nenshkrimit te kontrates duhe te sjell(ofroj) te menaxheri I kontrates disa modele(tipe) te materialeve per te gjitha pozicionet dhe te marr aprovimin nga menaxheri per llojin, ngjyren, formen etj.				
I	Inventarizimi				
1	Furnizmi dhe montimi me tavoline pune ne forme "L" me dim 2.0 x 0.9m dhe 1.75*0.75 m me 1 sirtar me minimum 3 fioka, njeri fiok te jete me qeles, Tavolina nga drurit i klasit te parë, materiali i druri MATT (ngjyra dhe modeli te percaktohet nga investiori)	cope	2	300.00	600.00
2	Furnizimi me karrige per persona te administrates komunale. Karriget te jene te levizshme dhe me mekanizem per rrotullim. Karriget duhet te kene mbeshtese te pasme dhe mbeshtetese per duar, gjithashtu duhet te kene edhe mekanizmin per ngritje te uleses dhe mekanizmin per levizje te mbeshteteses. Modeli dhe ngjyra e karrigeve te perzgjedhet nga organi mbikqyres.	cope	30	70.00	2,100.00
3	Furnizmi me tavoline me dim 110 x65cm, Tavolina nga drurit i klasit te parë, materiali i drurit te jete MATT (ngjyra, modeli dhe forma te percaktohet nga investior)	cope	2	90.00	180.00
4	Furnizmi dhe montimi me tavoline pune me dim 2.0 x 0.8m' me 1 sirtar me minimum 3 fioka, njeri fiok te jete me qeles. Tavolina nga drurit i klasit te parë, materiali i drurit te jete MATT (ngjyra, modeli dhe forma te percaktohet nga	cope	4	140.00	560.00



	investitori)				
5	Furnizmi dhe montimi me tavoline pune me dim 1.75 x 0.75m' me 1 sirtar me minimum 3 fioka, njeri fiok te jete me çeles. Tavolina nga drurit i klasit te parë, materiali I drurit te jete MATT (ngjyra, modeli dhe forma te percaktohet nga investitori)	cope	9	120.00	1,080.00
6	Furnizimi dhe montimi I ormaneve me material prej druri te klasit te pare, druri te jete MATT, dyert e ormaneve te jene nga material I xhamit ne pjesen e sipërme kurse pjesa e poshtme nga materiali I drurit, dim 1.0x1.8 m me thellesi minimale 40cm (ngjyra, forma dhe modeli te percaktohet nga investitori)	Cope	16	100.00	1,600.00
7	Furnizmi dhe montimi me tavoline pune me dim 1.40 x 0.8m'.tavolina te jete ne form ovale. Tavolina nga druri i klasit te parë, materiali I drurit te jete MATT (ngjyra, modeli dhe forma te percaktohet nga investitori)	cope	1	160.00	160.00
8	Furnizim me karrige statike per zyre. Karriget te jene te llojit RUMBA (ose ekuivalent), ngjyra, modeli dhe lloji te percaktohet nga investitori.	cope	12	30.00	360.00
	Gjithesejt:				6,640.00

REKAPITULIMI					
I	Inventarizimi				
	REKAPITULIMITOTAL :			1,100.00	6,640.00



IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISE	TRENTY HOME SHPK
ADRESA E PLOTE	LUPISHTE, PRIZREN
PERFAQESUAR NGA:	
EMRI	MEHDI LUMI
POZITA	DREJTOR
NENSHKRIMI	
DATA	06.11/2018
VULA	